

Përmbledhje e shkurtër e Konkluzionit të miratuar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës për fillimin e procedurës për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, për projektin investues të Shoqërisë për shërbime EMAPTA SHPKNJP Shkup

Lënda nr.10-178 të datës 15.12.2023 (nr.10-12 të datës 08.02.2024, përkatësisht 10-28 të datës 30.01.2025)

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), më datë 30.01.2025 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës filloi procedurën për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore për kompaninë EMAPTA SHPKNJP Shkup për shkak të faktit se ekzistojnë dyshime serioze për lejueshmërinë e dhënies së ndihmës përmes masës së përfshirë në njoftimin për dhënien e planifikuar të ndihmës nr. 10-178 të datës 15.12.2023 të dorëzuar nga Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale dhe si rezultat i asaj që u tha mësipërm, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vepron në përputhje me nenin 4 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/11).

Objekt i Marrëveshjes është dhënia e ndihmës shtetërore për EMAPTA SHPKNJP Shkup për realizimin e projektit investues në zonë.

Ndihma shtetërore si ndihmë individuale është për krijimin e vendeve të reja të punës për të punësuarit me orar të plotë deri në datën e përfundimit me pagë bazë mujore neto e cila është të paktën 50% më e lartë se paga mesatare neto në nivel shtetëror e përcaktuar nga Enti Shtetëror i Statistikave në ditën e nënshkrimit të Kontratës, ku parashikohet një grant prej 3,250 euro (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë euro) për një të punësuar. Dhënësi i ndihmës shtetërore do të fillojë me pagesën e ndihmës shtetërore në momentin kur përfituesi i ndihmës ka të punësuar të paktën 100 punonjës. Përfituesi i ndihmës planifikon që në vitin 2027 dhe 2028 të realizojë shumën totale të kostove të pranueshme për paga prej 33,000,000 euro (tridhjetë e tre milionë euro) dhe të krijojë 850 vende pune me afat të caktuar ose të pacaktuar në përputhje me kontratën e punësimit me orar të plotë.

Lidhur me njoftimin e dorëzuar për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore shoqërisë së shërbimeve EMAPTA SHPKNJP Shkup si dhe paketën e konceptuar të përfitimeve të përfshira në Propozim-kontratën për dhënien e ndihmës shtetërore, për KMK ekzistojnë dyshime serioze për lejueshmërinë e dhënies së një ndihme të tillë për shkak të:

- dyshimit nëse projekti investues përbën një investim fillestar produktiv sipas nenit 3 paragrafi (1) pika (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.109/13);
- përfshirjes nën kategorinë e të punësuarve edhe të personave që tashmë janë në marrëdhënie pune para datës së fillimit, përkatësisht punonjësit ekzistues të punësuar në Shoqërinë e Shërbimeve EMAPTA SHPKNJP Shkup do të transferohen në ZZHTI 1 dhe do të shfrytëzojnë masën për krijimin e vendeve të reja të punës, sipas Propozim-Kontratës për dhënien e ndihmës shtetërore.
- paqartësisë në Propozim-kontratë se vendet e reja të punës nënkuptojnë punësimin e personave shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika (2) të Rregullores për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës rajonale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 109/13), ftohen personat e

interesuar të dorëzojnë komente dhe mendime me shkrim për masat e parashikuara në Kontratën për dhënie e ndihmës shtetërore, për të cilat Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës miratoi konkluzionin për fillimin e procedurës për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore. Komentet dhe mendimet e personave të interesuar mund të dërgohen në adresën: Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54 (kati i 6-të), 1000 Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të përmbledhjes së shkurtër të Konkluzionit.

Shkup, 30.01.2025